



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMUNA E PODUJEVËS
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
Datë: 07.09.2022

Bazuar në nenin 62 pika 3, të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040. Rregulloren MF-Nr.04/2017, mbi kriteret standarte dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 61 paragrafi 1 dhe 2 të statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050832/18 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet, programeve të organizatave joqeveritare në Komunen e Podujevës nr. Protokollit 09-024/01-0077274/22 datës 07.09.2022

THIRRJE PUBLIKE

Për të gjitha organizatat joqeveritare në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushën e artit dhe kulturës, të aplikojnë për mbështetje financiare në thirrjen publike për project-propozimet për prodhimin e shfaqjes teatrore PËR FËMIJË, për repertorin e Teatrit të qytetit të Podujevës "Avdush Hasani".

1. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekt-propozimet për prodhimin e shfaqjeve teatrore si më poshtë:

a) **Shfaqje për fëmijë** - autor shqiptar ose i huaj;

Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen në këtë thirrje publike.

Për shfaqjet e propozuara sipas pikës 1 dokumentet specifike janë:

- ❖ Biografia e autorit/es;
- ❖ Deklarata e autorit/es (që ia jep të drejtën aplikantit për të konkurruar me dramën/veprën e autorit përkatës);
- ❖ Sinopsisi i dramës;
- ❖ Teksti i shfaqjes
- ❖ Biografia e regjisorit/es;
- ❖ Koncepti regjisorial;
- ❖ Biografi të anëtarëve tjerë të ekipit kreativ (nëse janë përzgjedhur);

Dokumentet e detyrueshme:

Për OJQ-të:

- ❖ Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- ❖ Çertifikata e nr. fiskal;
- ❖ Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- ❖ Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- ❖ Konfirmim nga Drejtoria e Kulturës që e keni përmbyllur projektin paraprak.
- ❖ Deklarata e partneritetit-[/DEKLARATA-E-PARTNERITETIT-2022.doc](#)
- ❖ Deklarata mbi financimin e dyfishtë-[/DEKLARATE-MBI-FINANCIMIN-E-DYFISHTE-2022.docx](#)
- ❖ Formulari i projekt-propozimit të thirrjes publike/[Formulari-i-Projekt-Propozimit-i-thirrjes-publike nga-DKRS-2022.docx](#)
- ❖ Formulari i propozim-buxhetit-[/FORMULARI-I-PROPOZIM-BUXHETIT-2022.docx](#)
- ❖ Udhëzuesi për aplikim-[Udhëzuesi-per-Aplikuesit-e-thirrjes-publike-nga-DKRS-2022.docx](#)

2. Vlera e përgjithshme e planifikuar për këtë thirrje është 10,000€ (Euro). Shuma maksimale e mbështetjes financiare që mund të alkohet për projekt është 10.000 € (Euro).

Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, pra nga data 08.09.2022 deri më 28.09.2022.

Periudha e zbatimit projektit është tetor 2022 – Dhjetor 2022

3. Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për kulturë:

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës;
- OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Podujevës;
- OJQ-të të cilat nuk kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje;
- OJQ-të të cilat nuk kanë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (për të njëjtat linja buxhetore).
- Duhet të mos ekzistoj ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo

institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi parandalimin e konfliktit të interesit në Republikën e Kosovës;

- Për të gjitha shfaqjet sipas pikës 1, mund të planifikohen edhe 6 aktorët rezidentë të Teatrit “Avdush Hasani”, përveç aktorëve të mundshëm nga jashtë. (përzgjedhja e aktorëve është fakultative);

- OJQ-të nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Podujevës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme;
- Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Podujevës.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar në e-mail zyrtar në adresën:

Jakup.gashi@rks-gov.net

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në [Rregulloren për subvencione.](#)

Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin obligativ të kompletuar do të diskualifikohen.

Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.

Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në OJQ apo biznes, apo cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë bankare.

Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione. Kontrata do të gjenerohet ndaj sistemi andaj të dhënat e sistemit reflektohen në kontratë.

Vërejtje/Kujdes:

- ❖ ***Raporti Narrativ** - përfshin dëshmi nga projekti i aktivitetit me shkrim dhe nëpërmjet dëshmiave të fototografimit. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga Personi që ka nënshkruar marrëveshjen për subvencione. Raporti duhet të dorëzohet pas përfundimit projektit.*

Raporti narrativ i përgatitur duhet deklarohet:

- ❖ Të përfshijë dokumentacion mbështetës (si foto, regjistrime të ndryshme të aktiviteteve, etj).
 - ❖ Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues të subjektit grantmarrës
- ❖ **Raporti Financiar** – kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njejtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 të gjitha OJQ-të e regjistruara në Departamentin për OJQ, të cilave në vazhdim iu është dhënë Statusi i Përfitimit Publik duhet të përgatisin një raport vjetor të projektit.

Raporti financiar i përgatitur duhet deklarohet:

- ❖ Të përshkruajë të gjitha shpenzimet në përputhje me buxhetin original duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera;
 - ❖ Të përshkruajë çdo pajisje të blerë;
 - ❖ Të evidentojë çdo fond të pashpenzuar (të cilat duhet të kthehen ose për të cilat kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit);
 - ❖ Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues.
- ❖ Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.
- ❖ Ju lutemi që raportin ta shkruani në **formë elektronike** (të printuara).
Raportet me dorëshkrim nuk pranohen.
- ❖ Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën pritëse, kati i parë në Komunën e Podujevës, **në zarfe të mbyllura.**
- ❖ Nuk do merren në shqyrtim OJQ-të, të cilat nuk janë treguar të përgjegjshme në deklarinimin dhe formën e mbajtjes së aktivitetit në vitin paraprak.
- ❖ Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të cekura më lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur.

Këtë mund ta bëni dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Adresa është e njëjtë në të dyja rastet:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Rruga "Nuhi Gashi", Kutia postare 1001

Në zarf të shkruhet qartazi:

Drejtuar Zyrës së Shërbimit për qytetarë në Komunën e Podujevës:
Aplikim në kuadër të Thirrjes për projekt-propozime për kulturë për vitin 2022.

Emri i aplikantit: _____

Titulli i projektit: _____

DREJTORIA PËR RINI DHE SPORT, DO TË VAZHDOJ PROCEDURAT E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE KONFORM DISPOZITAVE TË PËRCAKTUARA LIGJORE. POR PËR SHKAK TË GJENDJES SË KRIJUAR NGA COVID 19, MËNYRA E REALIZIMIT TE PROCEDURAVE TË THIRRJES PUBLIKE DO TË JETË KONFORM VENDIMEVE TË NIVELIT LOKAL DHE QENDROR.



DREJTOR

për Kulturë, Rini dhe Sport

Paftim Balaj